



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

*Dokument parlamentar*

*Tiranë, më 22.09.2020*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN**

**"PËR METROLOGJINË"**

***Hyrje***

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 21.09.2020, mori në shqyrtim projektligjin "Për Metrologjinë".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për të dhënë shpjegime rreth pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, ishin të pranishëm dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë znj. Belinda Ikonomi zv. Ministre, si edhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, drejtori i përgjithshëm z. Petrit Rama si edhe specialist të tjerë pranë drejtorisë.

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

**II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ**

Vizioni i zhvillimit të qëndrueshëm, kërkon një ecuri konstante dhe të matur të politikave të zhvillimit ekonomik të ndërvarura edhe me politikat sektoriale. Projektligji ka për qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator për veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe

ligjore, sipas praktikave më të mira evropiane, si dhe krijimin e një klime të lirë të ekonomisë së tregut. Forcimi imbiqëqyrjes së tregut dhe përmirësimi i zinxhirit dhe gjurmshërisë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, duke garantuar konsumatorin me shërbime të sigurta dhe me standarte evropiane objekt i këtij ligji.

Hartimi i këtij projektligji synon arritjen e disa objektivave si:

- a) përafrimin me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian;
- b) lëvizjen e lirë të instrumentave matës, në përputhje me MID (Measuring Instruments Directive);
- c) eliminimin e disa barrierave teknike të panevojshme në tregti;
- ç) unifikimin e termave të projektligjit, në përputhje me VIM (Fjalorin Ndërkombëtar të Metrologjisë);
- d) krijimin e dispozitave përkatëse që sigurojnë funksionimin e aktiviteteve metrologjike dhe të mbikëqyrjes së tregut, në dy institucione të ndara.

Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të praktikave për funksionimin e një tregu të sigurt, të lirë e konkurrues, në bashkëpunim me strukturën e mbikëqyrjes së tregut, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve, përmirësimin jetës së qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dukeju garantuar nëpërmjet instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në treg, jo vetëm një ekonomi të konkurrencës së ndershme, por edhe mbrojtjen e interesave të tyre ekonomikë.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me Ligjin Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me legjislacionin në fuqi.

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Shkalla e përputhshmërisë së këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, rezulton në një përputhshmëri të pjesshme, pasi projektligji është në përputhje me parimet kryesore të burimeve parësore dhe dytësore të aquis-së, por jo me të gjitha për shkak se implementimi i këtyre rregullave në praktikë nuk ka të njëjtin impakt pozitiv në vendin tonë, siç mund të ndodhë në shtete të tjera, duke iu referuar kushteve dhe rrethanave të ndryshme.

Projektligji i propozuar është në përputhje me:

1. Direktivën Këshillit 80/181/EEC për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, që kanë të bëjnë me njësitë e matjes;
2. Direktivën 2009/3/EC, datë 11 mars 2009, “Për njësitë e matjes”, e cila amendon direktivën 80/181 EEC;
3. Direktivën 2009/34/KE, datë 23 prill 2009, në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matëse dhe metodat e kontrollit metrologjik;
4. Direktivën 2007/45/EC, datë 5 shtator 2007, “Për vendosjen e rregullave për sasitë nominale të produkteve të parapaketuara”;

5. Direktivën 75/107/EEC, datë 20 janarit 1976, Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse;

6. Direktivën 2014/31/EU, datë 26 shkurt 2014, “Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në dispozicion në treg të instrumenteve joautomatikë të peshimit” ;

7. Direktivën 2014/32 EC, për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me përgatitjen dhe vendosjen në treg të instrumenteve matës;

8. Direktivën 76/211/EEC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 20 janar 1976.

## **V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë pasi nuk krijon ndonjë strukturë të re shtetërore, por do të shfrytëzohet e njëjta infrastrukturë ekzistuese (godina, pajisje, makineri etj).

## **VI. SUGJERIME NEN PER NEN**

**Neni 1.** : Neni 1 “Objekti”, sugjerohet të kaloj si Neni 2

**Koment:** *Sipas teknikës legjislative dhe standarteve ndërkombetare, neni “Qëllimi” duhet të jetë neni i parë i një projektligji. Sic mund të vërehet edhe nga strukturimi në nene të Konventave të Kombeve të Bashkuara, në nenin e parë, fillohet gjithnjë me definimin e qëllimit (Article 1. “Statement of purpose”).*

Për tre nenet e para, sugjerohet struktura si më poshtë:

**Neni 1 “Qëllimi”**

**Neni 2 “Objekti”**

**Neni 3 “Përkufizime”**

**Neni 2** “Qëllimi”, sugjerohet të kaloj si Neni 1.

**Neni 4:**

Sugjerohet riformulimi i nenit 4 si edhe shtimi i disa pikave të tjera, për të komplementuar dhe qartësuar një aspekt shumë të rëndësishëm të ligjit, në lidhje me të drejtën e informimit nga publiku; sugjerimi si vijon:

”1. Rezultatet e matjeve, të kryera me kërkesë të organizmave qeveritarë ose që i shërbejnë nevojave të institucioneve shtetërore në Republikën e Shqipërisë, dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, do të jenë në dispozicion të personave juridikë dhe fizikë kërkuar, në përputhje dhe brenda kufijve të parashikuar nga kuadri rregullator dhe legjislacioni përkatës në fuqi që përcakton disponibilitetin e informacionit me rëndësi publike.”

“2. Çdo person ka të drejtë të njihet me rezultatet e matjeve, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

**“3. Kërkesa për informim** bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

1. emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
2. adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
3. përshkrimin e informacionit që kërkohet;
4. formatin në të cilin preferohet informacioni;
5. çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

**“4. E drejta** për vënien në dispozicion të rezultateve të matjeve kufizohet vetëm sipas rasteve të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.”

**“5. Çdo person,** kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara për vënien në dispozicion të rezultateve të matjeve nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.”

### **Koment:**

*Qellimi i shtimit të pikave 2, 3, 4 dhe 5 me siper është për të garantuar sigurinë juridike të projektligjit. Siguria juridike parakupton, vec të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Në lidhje me të drejtën e informimit për matjet e kryera, ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre për informimin publik.*

### **Neni 6:**

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 3 si vijon:

“3. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë.”

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 2 si vijon më poshtë, si edhe sugjerohet që pika 2 të kaloj si pika 3; ndërkohë pika 3 e nenit 6 të projektligjit të kaloj si pika 2.

“Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë janë nëpunës civilë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil. Për personelin mbështetës, marrëdhëniet rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.”

### **Struktura për nenin 6 të projektligjit pas riformulimit dhe ristrukturimit të pikave:**

“1. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik publik, i specializuar për metrologjinë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

2. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miratohet me urdhër të Kryeministrit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë janë nëpunës civilë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil. Për personelin mbështetës, marrëdhëniet rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.”

#### **Neni 7:**

1. Sugjerohet riformulimi i pikës 2 si vijon:

“2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”

#### **Neni 9:**

1. Pas pikës (c) sugjerohet shtimi i një pike tjetër (ç) si vijon:

“*Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të Inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë për heqjen nga tregu të instrumentit matës, parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse. Personat fizikë dhe juridikë pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ pranë Inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e metrologjisë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.* »

#### **Koment :**

*Kjo shtesë synon që të harmonizojë dispozitat e ligjit me dispozitat e K.Pr.Administrative, konkretisht nenin 129 “Shterimi i mjeteve ligjore administrative”.*

#### **Neni 42 :**

1. Sugjerohet të shtohet një pikë 3 në lidhje me procesin e ankimit, në rast të shfuqizimit të vendimit për autorizim, si vijon:

“Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të shfuqizimit të autorizimit. Kundër shfuqizimit të vendimit për autorizimin, personat juridik apo fizikë pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. “

#### **Neni 46 :**

1. Sugjerohet riformulimi i nenit 46 të projektligjit si vijon:

“Inspektimi metrologjik kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë, në përputhje me këtë ligj si dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”

#### **Neni 49 :**

1. Sugjerohet riformulimi i nenit 49 të projektligjit, si vijon:

“Inspektori informon subjektin për kryerjen e inspektimit sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur një gjë e tillë çënon efektivitetin e inspektimit.”

### **Neni 50 :**

1. Sugjerohet të shtohet një pikë 5 pas pikës 4 në lidhje me procesin e ankimit, në rast të vendimit për ndalimin e vendosjes apo heqjes nga tregu kur konstatohet se instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, parapaketimet dhe shishet si enë matëse, që do të vendosen në treg, janë jo në konformitet me rregullat teknike; sugjerimi si vijon:

“Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit për ndalimin e vendosjes apo heqjes nga tregu, kur konstatohet se instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, parapaketimet dhe shishet si enë matëse, që do të vendosen në treg, janë jo në konformitet me rregullat teknike. Personat juridik apo fizike pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

### **Neni 54:**

Sugjerohet të rishikohet shkalla e proporcionalitetit të gjobave, në bazë të frekuencës së shkeljeve, duke respektuar parimin e proporcionalitetit të gjobave në harmoni me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin.

### **Neni 55 :**

Sugjerohet riformulimi i nenit 55 të projektligjit, si vijon:

“Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektorit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

### **Neni 56:**

Sugjerohet riformulimi i nenit 56 të projektligjit, si vijon:

“Gjoha ekzekutohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Të ardhurat e arkëtuara nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.”

### **Neni 57:**

1. Sugjerohet që në respektim të detyrimit kushtetues, konkretisht neni 118 i Kushtetutës, të përcaktohen saktësisht të gjitha dispozitat që kanë nevojë për akte nënligjore si edhe të përcaktohen afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore. Neni 118 i Kushtetutës ka parashikuar se:

*1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*

*2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

*3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.*

### **Koment:**

*Të përcaktohet kohëzgjatja (3 muaj ose 6) për nxjerrjen e akteve nënligjore, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimit të ligjit në kohë, për të realizuar sa më shpejt objektivat e tij.*

### **Neni 58:**

**1.** Në pikën 2 të nenit 58, sugjerohet që pas fjalisë së parë të shtohet fjalia si vijon: “Cdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”

Riformulimi:

”Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit Nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, që nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në daljen e akteve të reja nënligjore përkatëse, referuar këtij ligji. Cdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”

## **VII. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION**

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, për të avancuar më tej përmirësimin e kuadrit rregullator për veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe ligjore, sipas praktikave më të mira evropiane, si dhe krijimin e një klime të lirë të ekonomisë së tregut. Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qëndrimin e relatores dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, deputeti Z. Fino diskutoi në lidhje me nenin 6 të projektligjit duke argumentuar se pozicioni i *Drejtorit të Përgjithshëm të Metrologjisë* nuk duhet të jetë nëpunës me status civil duke qenë se organizimi dhe funksionimi i *Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë* rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Për më tepër, deputeti Fino argumentoi se edhe struktura organike e *Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë* miratohet me urdhër të Kryeministrit. Pra, deputeti Z. Fino argumentoi se dispozitat e sipërpërmendura të nenit 8 sugjerojnë se Drejtori i Përgjithshëm duhet të emërohet nga Kryeministri apo Këshilli i Ministrave. Më tej, deputeti Fino vazhdoi argumentin duke ilustruar faktin se tashmë ka ekzistuar dhe ekziston prej kohësh kuadri rregullator që Drejtorët e Përgjithshme të këtij niveli emërohen dhe nuk zgjidhen nga radhët e nëpunësve civilë. Relatorja e projektligjit, Znj. Xhina sugjeroi se nëse komisioni përgjegjës do të merrte në konsideratë sugjerimin e deputetit Fino, kjo do të duhej të shoqërohej edhe me nevojshmërinë për ti shtuar një dispozitë tjetër nenit 6, ku eventualisht do të duhej të përcaktoheshin qartë kushtet dhe kriteret që duhet të ployësojë kandidati për emërim si edhe procedurat e hollësishme të emërimit, në rast të pranimit të sugjerimit të deputetit Z. Fino.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, deputetja Znj. Hysi diskutoi në lidhje me nenin 54 duke kërkuar dhe sugjeruar komisionit përgjegjës që të rishikohet shkalla e proporcionalitetit të gjobave në bazë të frekuencës së shkeljeve për të respektuar parimin e proporcionalitetit të gjobave në harmoni me Kushtetutën si dhe me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin. Prandaj, deputetja Hysi kërkoi që komisioni përgjegjës të marrë në konsideratë që dispozitat e nenit 54 të jenë në harmoni të plotë me parimet kushtetuese për domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin në përcaktimin e masave administrative dhe nivelit të gjobave, duke kërkuar gjoba në vlerë monetare më të lartë për shkelësit në kushtet e përsëritjes.

Relatorja e projektligjit Znj. Xhina në lidhje me nivelin monetar të gjobave, arsyetoi se jurisprudenca kushtetuese dikton se ndërhyrja e ligjvënësit duhet të respektojë kriteret e mëposhtme:

*(i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës;*

*(ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike;*

*(iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.*

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, deputeti Z. Fino dhe deputetja Znj. Hysi gjithashtu, iu bashkuan diskutimit të relatores dhe kërkuan të theksohet për komisionin përgjegjës se në respektim të detyrimit kushtetues sipas nenit 118 të Kushtetutës, të përcaktohen saktësisht të gjitha dispozitat që kanë nevojë për akte nënligjore si edhe të përcaktohen afatet për nxjerrjen e akteve.

## **VIII. PËRFUNDIM**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë dhe vendosi t'ia kalojë komisionit përgjegjës, duke vlerësuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

**RELATORE**

**ELENA XHINA**

**KRYETARI**

**ULSI MANJA**